



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2869 Prot.

Roskovec, më 18.09 2024

V E N D I M

Nr. 27, datë 17/09 /2024

“ PËR MIRATIM TË PËRDORIMIT TË FONDIT TË EMERGJENCAVE CIVILE PËR VITIN 2024”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar, neni 9 , pika 1.3 , neni 29 dhe neni 54 pika dh , të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore“ neni 45 , të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar neni 44 dhe 45 , të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM Nr. 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” pika 3 paragrafi 3/1, gërma e , Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 109 datë 21.12.2023 “Për miratimin e buxhetit , numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarjeve vartëse për vitin 2024” si dhe materialeve të sjellë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit ; Këshilli i Bashkisë,

-VENDOSI :

- I. Të miratohet përdorimi i fondit për objektin : “Fuqizimi me një pompë të re i stacionit të pompimit të Arapaj ,zona Suk, Bashkia Roskovec” në shumën **2,058,182 lekë** , i cili të përballohet nga Fondi i kushtëzuar i Emergjencave Civile 2024.

NR	GR	TIT	KAP	ART	EMËRTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Vlera e plotë e objektit	2024	2025
1.	17	10910	1	604	Fuqizimi I stacionit të pompimit të ujitjes nga lumi Seman , zona Suk-Arapaj , Bashkia Roskovec	2,058,182	2,058,182	0
SHUMA:						2,058,182	2,058,182	0

- II. Ngarkohet Administrata e Bashkisë dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

- III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2870 prot.

Roskovec, më 18.04.2024

VENDIM

Nr. 28, datë 17.04.2024

PËR

**MIRATIMIN E AKTIT TË THEMELIMIT DHE STATUTIT TË “SHOQËRISË SË
TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER” SH.A**

Në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, në mbështetje të Marrëveshjes për krijimin e subjektit të përbashkët të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier”, lidhur midis Bashkisë Fier, (nr. 9851 Prot, datë 11.11.2022), Bashkisë Lushnje (nr.10108 Prot., datë 14.11.2022), Bashkisë Divjakë (nr.5947 prot., datë 11.11.2022), Bashkisë Patos (nr.2670/1 Prot., datë 11.11.2022), Bashkisë Roskovec (nr.10096 Prot., datë 14.11.2022), Bashkisë Mallakastër (nr. 5618 Prot., datë 14.11.2022) si dhe Autorizimeve të dhëna me Vendimin nr. 81, datë 27.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Fier, Vendimin Nr. 77, datë 13.10.2022 të Këshillit të Bashkisë Patos, Vendimin nr. 52, datë 28.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Mallakastër, Vendimin nr. 69, datë 30.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Roskovec, Vendimin nr. 92, datë 25.10.2022 të Këshillit të Bashkisë Lushnje, Vendimin nr. 49, datë 26.10.2022 të Këshillit të Bashkisë Divjakë, bazuar në ligjin nr.139/2015” Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 54, gërma “d”, Këshilli i Bashkisë

VENDOSI :

1. Miratimin e Aktit të themelimit dhe Statutit të “Shoqërisë së Trajtimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier” sh.a.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Roskovec për ndjekjen e procedurave të mëtejshme administrative-ligjore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR
Afrim Plaka**

